

V E N D I M
Nr. 410, datë 29.8.2002

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR GJIROKASTËR -KAKAVIJË
NË TERRITORIN E QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Gjirokastrë-Kakavijë në territorin e qarkut të Gjirokastrës.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqet 50 923 m² tokë/arë, 9 565 m² truall, 24 957 m² kullotë dhe 741 664 lekë kultura bujqësore, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 59 333 764 (pesëdhjetë e nëntë milionë e treqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekësh.
 4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën prej 756 000 (shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekësh.
 5. Fondi prej 60 089 764 (gjashtëdhjetë milionë e tetëdhjetë e nëntë mijë e shtatë qind e gjashtëdhjetë e katër) lekësh të përballohet nga Buxheti i Shtetit i vitit 2002, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.
 6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.9.2002.
 7. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano